



RAPORT STATISTIKOR **JANAR-MARS 2024**

Hyrje

Raporti synon të japë një përshkrim analitik të treguesve të primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara të Tregut të sigurimeve dhe me pas të shoqërisë Insig sh.a për periudhën janar-mars 2024, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si edhe për tregues specifikë të dhënat krahasohen për periudhën janar-mars të viteve nga 2020-2024. Në përfundim të raportit ndërtohen projeksione dhe jepen vlerësime të mbështetura në fakte dhe gjykime.

Burimet kryesore mbi të cilat mbështetet raporti janë; Buletini Statistikor zyrtar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën janar-mars 2024 dhe të dhënat statistikore të përpunuara për periudhën në shqyrtim, të shoqërisë Insig Sh.a

Tabela e përmbajtjes

1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Mars 2024.....	2
1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës	3
1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës	4
2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Mars 2024	5
2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të aksidenteve	6
2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike	7
2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës	8
2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera	8
3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Mars 2024.....	9
3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike	9
3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit	10


1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Mars 2024

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-mars 2024 ka realizuar 5,227,831 mijë lekë prime të shkruara bruto nga tregu i sigurimit të Jetës, JoJetës dhe veprimtaria e risigurimeve duke shënuar rritje me 1.68% krahasuar me periudhën janar-mars 2023. Nga aktiviteti i Jo Jetës janë realizuar 4,756,871 mijë lekë prime duke shënuar një rritje me 0.69% dhe nga aktiviteti i Jetës janë realizuar 466,986 mijë lekë prime duke shënuar një rritje prej 12.28%, kurse veprimtaria e risigurimeve ka realizuar 3,975 mijë lekë duke shënuar një rritje prej 0.03. Vlera e dëmeve të paguara nga industria e sigurimeve është 1,996,044 mijë lekë me një rritje prej 23.88% krahasuar me periudhën janar-mars të vitit 2023. Njësoj si treguesit e primeve të shkruara, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara afro 89.03% e tyre paguhet nga aktiviteti i Jo Jetës, 3.19% e tyre nga aktiviteti i Jetës dhe 6.91% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit.

1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës


Totali i primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës është 4,756,871 mijë lekë duke shënuar rritje me 0.69% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Ndikimin kryesor në rezultatin e rritjes së përgjithshme të tregut krahasuar me janar-mars të vitit 2023, ka dhënë rritja në sigurimin Kasko 21.40%, në sigurimet e detyrueshme motorike me 9.82% rritja në sigurimet e aksidenteve e shendetit me 15.76%. Klasat e tjera rezultojnë me rënie sipas grafikut 1.

Grafiku 1: Ndryshimi i primeve të shkruara bruto sipas klasave të sigurimit, janar-mars 2024/2023




Duke ju referuar periudhës janar-mars për vitet 2020-2024 sipas grafikut 2, trendi i primeve rezulton me rritje nga viti 2020 në 2024 duke shënuar vlerën më të lartë në janar-mars 2024.

Grafiku 2: Ecuria e primeve të shkruara bruto tregu i sigurimeve, janar-mars 2020-2024 (mijë lekë)




Tregu vazhdon të dominohet nga klasa e sigurimeve të detyrueshme motorike duke zotëruar 63.41% të totalit të primeve të shkruara bruto, e ndjekur më pas me rreth 12.71% nga sigurimet e pronës ndërsa pjesa tjetër e ndarë midis klasave të tjera .Referuar grafikut 3, ku paraqitet raporti i sigurimeve vullnetare me ato të detyrueshme për periudhën janar-mars përpjesa që sigurimet vullnetare zënë ndaj sigurimeve totale është më e madhe në periudhën janar-mars të vitit 2023 me 41.86% prime vullnetare ndaj totalit. Ndërkohë që raporti më i ulët paraqitet në periudhën janar-mars të vitit 2024 me 36.59%. Për periudhën raportuese raporti rezulton 36.59% me 63.41%.

Grafiku 3: Raporti vullnetare/totalit për periudhën janar-mars 2020-2024 (mijë lekë)




Numri i kontratave të lidhura për sigurimet e Jo Jetës gjatë periudhës janar-mars 2024 është 278,728 kontrata, duke shënuar rritje prej 9.33% ose 23,780 kontrata më shumë se viti 2023. Ndërkohë, norma e rritjes së tregut është rreth 0.69 krahasuar me janar-mars 2023

Grafiku 4: Norma e rritjes së primit, janar- mars 2024/2023




Grafiku 5: Raporti vullnetare/totalit, janar-mars 2024



1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës


Gjatë periudhës janar-mars 2024 nga aktiviteti i sigurimit të Jo Jetës janë paguar 1,777,098 mijë lekë dëme, duke shënuar një rritje me 19.91% ose 295,089 mijë lekë pagesa më shumë krahasuar me periudhën janar-mars të vitit 2023 dhe kjo shoqërohet edhe me rritjen e numrit të rasteve të paguara me 25.65% ose 3,409 raste më shumë.

Grafiku 6: Ecuria e dëmeve të paguara nga tregu (mijë lekë), janar-mars 2020-2024



Sipas grafikur 6, vlera më e lartë e dëmeve të paguara është për periudhën janar-mars të vitit 2020. Faktori kryesor ndikues në këtë tregues janë tërmetet e ndodhura në fund të vitit 2019 dhe dëmshpërblimet gjatë vitit 2020. Gjate periudhës janar-mars 2024 ndërkohë që rritet vlera e dëmeve të paguara , rritet edhe numri i rasteve me 25.65% 3,409 raste më shumë.

Grafiku 7: Ndryshimi ne demet e paguara sipas klasave te sigurimeve , janar-mars 2023/2024




Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vjen nga lloji i sigurimeve motorike rreth 76.44% e totalit, ndjekur nga zjarri dhe dëmtimet e tjera në pronë me 13.36%, aksidentet dhe shëndeti me 9.23% dhe Të Tjera me 0.97%.

2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Mars 2024


Aktiviteti i shoqërisë INSIG për periudhën janar-mars 2024 për Tregun e Sigurimeve të Jo Jetës, u mbyll me një rezultat primesh të shkruar bruto prej 313,098 mijë lekë, duke shënuar **një rritje prej 7.59%** ose 22,075 mijë lekë më shumë krahasuar me periudhën janar-mars të vitit 2023. Krahasuar me janar-mars nga vitet 2020–2024, ecuria e primeve të shoqërisë Insig është pothuajse jo e rregullt, duke shënuar vlerën më të ulët në janar-mars të vitit 2020 dhe vlerën më të lartë të primeve të realizuara në janar-mars të vitit 2024 paraqitur grafikisht si më poshtë në grafikun 8.

Grafiku 8: Ecuria e primeve të shkruara bruto Insig, janar-mars 2020-2024 në mijë lekë



Raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit për periudhën janar-mars të vitit 2024 është 13.55% me 86.45%, duke shënuar një rënie në përqindje prej 1.68% të këtij raporti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ku raporti i vullnetareve ndaj totalit ishte 15.23%. Ecuria e këtij raporti për periudhën janar-mars nga 2020-2024 paraqitet sipas grafikut 9.


Grafiku 9: Prime vullnetare ndaj totalit Insig janar-mars 2020-2024 (mijë lekë)



2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të Aksidenteve e Shëndetit

Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2024 nga klasa e sigurimit të Aksidenteve dhe Shëndetit janë realizuar 2,923 mijë lekë prime të shkruara bruto duke shënuar një rënie me 50.27% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Primet e realizuara nga ky grup në raport me totalin zënë 0.93% e tyre. Grafiku 10, ilustron ecurinë e primeve të shkruara bruto për periudhën janar-mars nga vitit 2020-2024. Vlera më e ulët e primeve të grumbulluara shënohet për periudhën janar-mars të vitit 2021, ndërsa më e larta për periudhën janar-mars 2023.


Grafiku 10: Primet e shkruara bruto klasa e aksidenteve e shëndetit Insig janar-mars 2020-2024 (mijë lekë)



2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike


Në klasën e sigurimeve motorike, përfshihen sigurimet e detyrueshme motorike Tpl, Karton Jeshil, Kufitare dhe sigurimet vullnetare motorike, Kasko. Nga klasa e sigurimeve motorike shoqëria Insig për periudhën janar-mars të vitit 2024 ka grumbulluar 288,528 mijë lekë prime të shkruara bruto, duke shënuar rritje me 10.28% Vetëm nga sigurimet e detyrueshme motorike primet e shkruara bruto janë 270,669 mijë lekë, të cilat përbëjnë rreth 93.81% të gjithë primeve të klasës motorike. Nga sigurimet e detyrueshme motorike Tpl zë pjesën më të madhe dhe krahasuar me 2023 dhe ka një rritje 11.65%, Kartoni Jeshil ka një rënie me 0.32% dhe Kufitare ka një rritje me 8.35% Ndërkohë për periudhën janar-mars 2024, primet e shkruara bruto për sigurimin Kasko janë 17,859 mijë lekë, duke shënuar një rritje me 19.47% krahasuar me vitin 2023. Primet e kësaj klase zënë 6.19% të totalit të motorikeve. Primet e realizuara nga sigurimet motorike, bëjnë pjesën më të madhe të totalit të primeve të INSIG, duke zënë respektivisht 92.15% të tij. Për periudhën janar-mars të viteve nga 2020-2024 trendi i primeve të sigurimeve të detyrueshme motorike është në rritje, ku vlera më e ulët shënohet për janar-mars të vitit 2020 dhe vlera më e lartë në janar-mars të vitit 2024 sipas grafikut 11.

Grafiku 31: Ecuria e primeve - klasa e sigurimeve motorike të detyrueshme Insig, janar-mars 2020 - 2024 (mijë lekë)



Trendi i primeve të realizuara për sigurimet Kasko, është i luhatshëm duke parë ecurinë për periudhën janar-mars nga 2020-2024, ku vlera më e ulët shënohet në vitin 2020 dhe vlera më e lartë në vitin 2024 Sipas grafikut 12.

Grafiku 42: Ecuria e primeve Insig – klasa e sigurimeve kasko, janar-mars 2020-2024 (mijë lekë)



2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës

Në klasën e sigurimeve të Pronës sipas të dhënave të AMF-së, përfshihen përveç sigurimeve nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtime të tjera në Pronë edhe sigurimet e punimeve në ndërtim si CAR apo dhe EAR. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën janar-mars të vitit 2024 është 13,309 mijë lekë, duke shënuar rritje me 81.52% krahasuar me janar-mars të vitit 2023. Në raport me totalin e primeve të INSIG për periudhën janar-mars të vitit 2024, kjo klasë zë 4.25% të primeve totale të vetë shoqërisë. Ecuria e primeve bruto të kësaj klase për periudhën janar-mars nga 2020-2024 paraqitet në grafikun 13 , ku vihet re që vlera më e ulët i takon vitit 2020 dhe vlera më e lartë arrihet në vitin 2021.


Grafiku 13: Ecuria e primeve Insig - klasa e sigurimeve të pronës, janar-mars 2020-2024 (mijë lekë)



2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera

Në klasat e sigurimeve të tjera përfshihen llojet e sigurimeve të Garancive, Mallrave në Transport, Përgjegjësi, Aviacionit dhe Marinës. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën janar-mars të vitit 2024 është 8,338 mijë lekë. Në raport me totalin e primeve të realizuara për periudhën janar-mars të vitit 2024, ky grup realizon 2.66% të totalit. Sigurimi i Garancive zë peshën më të madhe në këtë grup, i ndjekur nga sigurimet e Përgjegjësi dhe me pas klasat e tjera të sigurimeve sipas grafikut 14.


Grafiku 54: Ecuria e primeve Insig për klasat e tjera, janar-mars 2020-2024 (mijë lekë)



3.Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Mars 2024


Për periudhën janar-mars 2024, totali i dëmëve të paguara nga shoqëria INSIG është 95,308 mijë lekë pagesa përfshirë edhe shpenzimet për trajtimin e dëmëve, duke shënuar një rënie me 18.72%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. INSIG renditet në vend të tetë në treg duke paguar rreth 5.36% të totalit të dëmëve të tregut. Ndërkohë numri i dëmëve të paguara është rritur me 78.07% ose 292 raste më shumë krahasuar me periudhën janar-mars të vitit 2023. Raporti dëme/prime për periudhën janar-mars 2024 rezulton të jetë 30.44%. Për INSIG, pjesa më e madhe e vlerës së pagesave për periudhën janar-mars 2024 i takon sigurimeve motorike që zënë 99.55% të totalit të pagesave, e ndjekur nga sigurimet aksidenteve dhe shëndetit me 0.29% të totalit të pagesave dhe sigurimi i Mallit në Transport me 0.16% të totalit. Më poshtë grafiku 15, paraqitja grafike e peshës specifike të pagesave që zë secila klase ndaj totalit, për periudhën janar-mars 2024.

Grafiku 15: Pjesa e dëmëve të paguara nga llojet e sigurimit Insig, janar-mars 2024



Duke ju referuar ecurisë së pagesave në vite vihet re që, për periudhën janar-mars nga viti 2020-2024, kemi një luhatje pagesash. Janar-mars i vitit 2023, shënon vlerën më të lartë të pagesave dhe viti 2022 shënon vlerën më të ulët. Raporti dëme/prime është më i lartë në vitin 2023 rreth 40.29% sipas grafikut 16.

Graiku 16: Ecuria e dëmeve të paguara të Insig, janar-mars 2020-2024 (mijë lekë)



3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike


Sigurimet motorrike për periudhën janar-mars 2024, kapin vlerën prej 94,8801mijë lekë ose 99.55% të totalit të pagesave. Nga karahasimi me periudhën janar-mars të vitit 2023, kemi një rritje prej rreth 24.46%. Brenda grupit 9.49% e pagesave i takon sigurimit motorik vullnetar Kasko dhe pjesa tjetër prej 90.51% i takon pagesave për sigurimet e detyrueshme motorike ku Tpl zë 82.69% ,Kartoni Jeshil 7.37% dhe Kufitare 0.45%. Referuar karahasimit me periudhën janar-mars të vitit 2023, TPL rezulton me rritje pagesash prej 64.51%, Kartoni Jeshil rezulton me rënie prej 42.66%, Kufitare rezulton me rritje prej 15.22% dhe Kasko rezulton me rënie prej 43.65%.

3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit

Pjesa tjetër e dëmeve të paguara vjen nga klasa e sigurimit të Pronës , Garancive dhe Aksidenteve e Shëndetit. Nga klasa e sigurimeve të Pronës dhe Garancive për janar-mars 2024

nuk kemi raportime pagesash .Vlera e dëmeve të paguara të Pronës për 2023 është 5,770 mijë lekë pagesa. Nga klasa e Përgjegjësi vlera e dëmeve të paguara është 150 mijë lekë. Përsa i përket Aksidenteve dhe Shëndetit për periudhën janar-mars 2024, vlera e dëmeve të paguara është 277 mijë lekë pagesa me një rënie prej 15.55% krahasuar me vitin 2023. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të realizuara për këtë klasë është 9.48%.Kjo klasë në raport me pagesat totale të tregut zë 0.17% të këtij totali. Grafiku 22: Pagesat sipas klasave dhe ndryshimi në përqindje sipas klasave të sigurimeve.

Grafiku 22: Pagesat sipas klasave dhe ndryshimi në përqindje sipas klasave të sigurimeve



D.Paguara	TPL	Karton Jeshil	Kufitare	Kasko	Aksid.&Shend d	Zjarr	Garanci	Përgjegjesi
2023	47,693	12,193	368	15,983	328	5,770	34,917	0
2024	78,458	6,993	424	9,006	277	-	-	150
Ndysh.%	64.51%	-42.65%	0.00%	-43.65%	-15.55%	0.00%	0.00%	0.00%